



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 221, datë 28.04.2023**

**PËR  
TRANSFERIMIN E GJYQTARES {...}, NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË  
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4 dhe 147/1/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 42 dhe 44/2B të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar Vendimit nr. 216 datë 28.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi zgjedhjen për tu transferuar në një nga pozicionet e lira të përherhme në gjykatat e të njëjtit nivel, të gjyqtares znj. {...}, mbi propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Transferimin e gjyqtares znj. {...}, në një pozicion të lirë në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Lezhë, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë ku është caktuar në mënyrë të përherhme.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.05.2023.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**